

VENDIMET E MBLEDHJES SË BORDIT 14 KORRIK 2021

Vendimi Nr. 2021-041

AGM TE dhe Development Workshop 2021

- Bordi me shumicë votash merr vendim që Kryetari Hadërgjonaj të merr pjesë në Mbledhjen Vjetore të Tennis Europe, ndërsa Drejtori për Zhvillim Shkelzen Domi të merr pjesë në Development Workshop. Aktivitetet do të mbahën në Luxemburg nga datat 22-25 Shtator 2021.
- Për AGM TE, FTK do të mbulojë kostot e transportit dhe te hotelit qe nuk mbulohen nga TE, ndërkaq për Development Workshop do të pranohet granti prej 500 USD për shpenzimet e udhëtimit.

Vendimi Nr. 2021-042

Specifikat për shpërndarjen e ndihmave tek klubet

- Bordi me shumicë votash miraton propozimin e Kryetarit për plotësimin e pikës 9. të rregullorës financiare 03 për përkrahjet e klubeve.
- Një ekip prej 3 persona do të punojnë në definimin e kushteve për shpërndarjen sa më efektive të ndihmave tek klubet dhe të njejtat do të dërgohen në bord për aprovim.

Vendimi Nr. 2021-043

Programi intensiv i ushtrimeve

- Bordi me shumicë votash merr vendim që programi intensiv i ushtrimeve të ristatroj përsëri në shtator 2021. Ky program do të vazhdojë edhe për pesë (5) muaj nga muaji shtator- janar 2021, me trajnerin teknik Granit Bajraliu, 1 ndihmës trajner dhe 1 trajner kondicional.
- Selektori në fjalë do të bëjë përgadisë plan programin dhe njëheri do të zgjedh edhe pjesëmarrësit e programit.

Vendimi Nr. 2021-044

Kampet U12/U14

- Bordi me shumicë votash merr vendim që kampi i dytë për këtë vit për grupmoshën U12 dhe U14 të organizohet gjatë muajit gusht 2021.

- Administrata do të kontaktoj selektorët e kategorive përkatëse për të kërkuar plan programin e tyre për kampet, datat, lokacionin dhe detajet tjerat të nevojshme.

Vendimi Nr. 2021-045

Shpërblimet monetare për garat e kategorisë Adult

- Bordi me shumicë votash merr vendim që këtë vit të lirojë klubet nga obligimet e tyre për shpërblimet monetare që klubet kanë kundrejtë lojtarëve të garave të kategorisë Adult.
- Klubet detyrohen që nga vitin 2022 të sigurojnë shpërblimet minimale për garat Adult, sipas pikës 25.3. në rregullorën 05 për garat zyrtare të FTK-së.

Vendimi Nr. 2021-046

Garat e FTK-së në kushte ekstreme

- Bordi me shumicë votash merr vendim që Komisionerja e Garave Blerata Ukëhaxhaj të hartojë një rregullore specifike që ka të bëjë me definimin e kriterëve në nivel vendi në situata të klimes ekstreme.
- Rregullorja do të ketë të definuara vlerat e temperaturës deri kur mund të mbahën garat për kategori përkatëse dhe kur ato duhet të shtyhen/anulohen për shkak të kushteve ekstreme.

Vendimi Nr. 2021-047

Angazhimi i Refereve të vijave

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimin e Kryetarit Hadërgjonaj të angazhojë referët e vijave në turnet e nivelit vendor si referë mbikqyrës.
- Angazhimi i refereve të vijave do të kalojë nga KRTK me rotacion që nga muaji korrik 2021.

Vendimi Nr. 2021-048

Tenisi në Shkolla

- Bordi me shumicë votash merr vendim që në shtator të 2021 të startojë me promovimin e tenisit në shkolla.
- Plani i këtij aktiviteti do të hartohet nga një grup punues i përbërë nga:
 - a) *Jeton Hadërgjonaj;*
 - b) *Blerina Mati;*
 - c) *Blearta Ukëhaxhaj.*

Vendimi Nr. 2021-049

Procesi i kalimit te lojtareve nga klubi ne klub dhe identifikimi i tyre me kartel

-Bordi me shumicë votash merr vendim të hartohen kriteret e kalimit të lojtarëve nga klubi në klub dhe të njejtat të aplikohen nga viti 2022.

-Bordi me shumicë votash merr vendim që nga viti 2022 tenistët të identifikohen me kartela.

-Tenistët do të pajisen me kartelë identifikuese posa të bëjnë pagesën vjetore të anëtarësisë në FTK.